



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik
-KUVENDI I KOMUNËS-

01Nr.16-5110/2014
Kaçanik: 28.02.2014

Në bazë të nenit 12, 14 lidhur me nenin 17 (f), në zbatim të pikës 3 dhe 5 Vendimit të Qeverisë Nr. 06/18 të datës 08.06.2011, të Shkresës së Komitetit të Ministrave për Ndërmarrjet Publike, të datës 04.02.2014 me të cilën Refuzohet Kërkesa e Komunës së Kaçanikut për Liçencimin e NKP "Lypeteni", Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 28.02.2014, mori këtë:

V E N D I M
PËR ZGJIDHJEN PËRFUNDIMTARE TË STATUSIT
TË NKP "LYPOTENI"

I.

Me këtë Vendim shfuqizohet Vendimi i Kuvendi të Komunës Kaçanik 01Nr. 1461/09 i datës 27.02.2009 -Për Shkëputjen e NJO "Lypoteni" nga KRU "Bifurkacioni.

II.

Implementohet Rekomandimi i Komitetit të Ministrave për Ndërmarrjet Publike dhe Vendimi i Qeverisë për kthimin e Ndërmarrjes Komunale për Ujësjellës dhe Kanalizim" Lypeteni" nën menagjimin e KRU "Bifurkacioni" me seli në Ferizaj.

III.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të pëkujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

V.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës – përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, dhe Arkiva.

Arsyetim

Kryetari i Komunës Kaçanik, iu ka drejtuar Kuvendit të Komunës Kaçanik, prej datës 20.02.2014 me Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 1461/09 për shkëputjen e NJO “Lypeteni” nga KRU “Bifurkacioni” në Ferizaj.

Edhe pse vlerësimet e DSHPE janë se NKP”Lypeteni nga shkëputja – nga viti 2009 nga KRU” Bifurkacioni” i Ferizajit ka funksionuar shumë mirë si e pavarur, mirëpo për shkak të statusit ligjor të pazgjidhur të kësaj ndërmarrje, kanë munguar investimet nga donatorët ndërkombetarë dhe nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Duke u nisur nga këto arsytetime, faktin se pjesa me e madhe e territorit të komunës nuk është i përfshirë në ujësjellës, sistemi ekzistues i ujësjellësit është me gypa të azbest betonit, me çka paraqet rrezik për shëndetin publik, në pamundësi të licencimit të shërbimeve të ujit nga organet kompetente si ndërmarrje komunale, Vendimit të Qeverisë Nr. 06/18 të datës 08.06.2011, të Shkresës së Komitetit të Ministrave për Ndërmarrjet Publike, të datës 04.02.2014 me të cilën Refuzohet Kërkesa e komunës së Kaçanikut për Liçencimin e NKP”Lypeteni”, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me date 28.02.2014, i mori parasysh të gjitha këto arsytetime dhe vendosi që Ndërmarrjen Komunale Komunale për Ujësjellës dhe Kanalizim “Lypeteni”, ta kthej në menagjim të KRU” Bifurkacioni” me seli në Ferizaj.

Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelal Gashi

